



Duke u bazuar në parimet e partneritetit të SPAR në mbarë botën **Ne në SPAR Kosova** kemi nisur udhëtimin në të ardhmen e “retail-it” Kosovar, duke u fokusuar tek konsumatorët tanë, të cilëve do t'ju ofrojmë cilësi të lartë dhe vlerë të shtuar për çmimin, duke garantuar freski, përzgjedhje, dhe shërbim të përsosur.

Nëse keni talent, përvojë, dëshirë dhe ju sfidon e ardhmja, **Ju japim mundësi t'i bashkoheni ekipit tonë në hapjen e dyqaneve të SPAR Kosova në Prishtinë**, duke aplikuar për pozitën në vijim:

Hulumtues dhe analist i tregut (m/f)

Hulumtuesi dhe analisti i tregut do të jetë pjesë e departamentit të marketingut, duke qenë përgjegjës për hulumtimin e rregullt dhe krahasimin e çmimit të produkteve të konsumit të gjerë si dhe aktiviteteve promovionale në tregun e Kosovës të shitjes me pakicë.

Përgjegjësitë e punës:

- Kryerja e vizitave të rregullta në pika shitëse
- Grumbullimi, analiza dhe interpretimi i të dhënave
- Përgatitja e raporteve analitike të çmimeve për artikujt kryesorë me vlerë dhe asortimanin në tërësi
- Përgatitja e raporteve mbi aktiviteteve promovionale dhe fushatat e marketingut
- Përgatitja e raporteve mbi risitë dhe trendet e tregut të shitjes me pakicë
- Përgatitja e raporteve mbi reagimet e konsumatorëve dhe hulumtimi i tregut Online
- Detyra të tjera sipas kërkesës në kuadër të lëmisë përkatëse

Edukimi dhe përvoja paraprake:

- Diplomë universitare në Biznes dhe Ndërmarrësi, Ekonomi, apo ndonjë fushë tjetër që ndërlidhet me lëminë përkatëse
- 2-3 vite përvojë paraprake në lëmi përkatëse
- Eksperencë paraprake në kryerjen e vizitave të rregullta në pika të shitjes me pakicë
- Njohuri paraprake për asortimanin e produkteve të konsumit të gjerë
- Njohja e gjuhës Angleze dhe pakos Microsoft Office.

Aplikimi: Kandidatët e interesuar mund të aplikojnë duke klikuar në butonin “Apliko”, ose duke shkarkuar formën për aplikim duke klikuar butonin “Shkarko Aplikacionin”, dhe së bashku me CV'në dhe Letrën Motivuese të dërgohen në email adresën: recruitment@spar-kosova.com, më së largu deri më 5 Maj 2019. Subjekti i emailit duhet të përfshijë pozitën e aplikimit.

Aplikacionet e pakompletuara nuk shqyrtohen!

> APLIKO

> Shkarko Aplikacionin